

V E N D I M
Nr. 362 datë 4.8.1999

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË SIGURIMIT, TË
BASHKËRENDIMIT DHE TË GRUPIT TË GATSHËM TË POLICISË,
PËR ASETET E SHOQËRIVE HUAMARRËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë apo bankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ngrihet dhe të funksionojë, deri në përfundim të procesit të transparencës, shërbimi i sigurimit, i bashkërendimit dhe grupi i gatshëm i policisë, për problemet e ruajtjes, zbulimit dhe rikthimit, pranë administratorëve të shoqërive huamarrëse, të aseteve të grabitura nga persona të tretë, fizikë apo juridikë.

2. Shërbimi i sigurimit dhe i bashkërendimit përbëhet nga dy specialistë, oficerë të Ministrisë së Rendit Publik dhe nga një grup i gatshëm policie. Detyrat funksionale dhe kompetencat e tyre përcaktohen me urdhër të veçantë të Drejtorisë së Policisë, pranë Ministrisë së Rendit Publik.

3. Shërbimit të sigurimit dhe të bashkërendimit i vihen në dispozicion një autoveturë policie, ndërsa grupit të gatshëm të policisë një furgon, të cilat sigurojnë lidhje të vazhdueshme me administratorët dhe drejtoritë e policisë në prefektura.

4. Specialistët e shërbimit të sigurimit dhe të bashkërendimit, për vështirësitë e punës që kryejnë, trajtohen me shtesë në pagë për vështirësi në punë, me urdhër të veçantë të Ministrit të Rendit Publik. Numri i specialistëve të shërbimit të sigurimit dhe të bashkërendimit dhe të grupit të gatshëm të policisë, si dhe fondi i pagave të tyre, përballohen nga buxheti i vitit 1999, i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko